



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

OPERATORIT EKONOMIK “ALBTELECOM” SH.A.
ADRESA: TIRANË KASHAR AUTOSTRADA TIRANË - DURRËS, KM.7

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” (Marrëveshje kuadër) me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Referenca e procedures: REF-83549-12-31-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data 2021-2023”

Fondi limit: 74.941.999,90 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e nëntë qind e nëntëdhjetë e nëntë e nëntë pikë nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutim: 3 (tre) vjet ose 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes/kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **Nr. 3 datë 11 Janar 2021.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme **X** çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ **me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori ekonomik “Albtelecom” sh.a NUIS J61824053N

Çmimi total i ofertës pa tvsh = 66.997.636.50 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekë .

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Albanian Satellite Communications” shpk me NUIS: K61814094W dhe “One Telecommunications” sh.a me NUISK62115018I

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **6.146.994** (gjashtë milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- **Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Albanian Satellite Communications” shpk me NUIS: K61814094W dhe “One Telecommunications” sh.a me NUISK62115018I**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Albanian Satellite Communications” sh.p.k dhe “One Telecommunications”, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.1.a) të Dokumentave Standarde të Tenderit, pasi formulari i ofertës ekonomike të paraqitur nuk përmban elementët e kontratës objekt prokurimi sipas Shtojcës 1 të DST:

Në formularin e ofertës së paraqitur nuk përputhet asnjë nga elementët e cituar më poshtë:

- Autoriteti Kontraktor i cituar nuk është Bashkia Tiranë, por Bashkia Elbasan.
- Objekti i cituar nuk është në përputhje me objektin e kësaj procedure objekt vlerësimi pra “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data 2021-2023”, por është “Shërbimi i internetit për Bashkinë Elbasan dhe Njësitë Administrative”.
- Nurmi I referencës së cituar (REF-84123-01-15-2021) nuk përputhet me nr. E references së procedurës object prokurimi (REF-83549-12-31-2020).
- Përshkrimi i shërbimeve në tabelën e paraqitur nuk përputhet me shërbimet e MK objekt prokurimi.
- Kohëzgjatja e MK, apo afati i shërbimit nuk përputhen me kohëzgjatjen e MK që prokurohet nga AK.

Referuar sa më sipër, konkludojmëse meqenëse formulari i ofertës ekonomike të paraqitur në spe, nuk përmbush asnjë nga elementët në lidhje me këtë procedurë prokurimi me objekt

“Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data 2021-2023” me fond limit 74,941,999.90 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë, presje nëntëdhjetë) lekë dhe Nr. reference REF-83549-12-31-2020, oferta ekonomike rezulton e pavlefshme

Referuar faktit se BOE nuk plotëson një nga kërkesat bazë të DST sikurse është ai i formularit të ofertës, pra ndodhur para faktit që kemi një ofertë ekonomike të pavlefshme, në vijim të arsytimit gjykojmë se gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomik “Albanian Satellite Communications” sh.p.k dhe “One Telecommunications” SH.A, nuk do të ndryshojë duke u s’kualifikuar nga procedura në fjalë, në mbështetje të nenit 55 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar).

Rjedhimisht, kriteret e tjeratë përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, të paraqitura nga BOE, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në zbatim të nenit 55 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) përcaktohet:

Oferta fituese duhet të jetë:

- a) *oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentete tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët;*

ose

- b) *oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme të lidhura me objektin kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kosto të funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha të lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriteret të jenë objektive dhe jo diskriminuese.*

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Mratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik “Albtelecom” sh.a me NUIS J61824053N

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **66.997.636.50 (njëzet e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dhjetë presje tridhjetë e tre) lekë**

Rjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë*, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 10.02.2021

Ankesa: ka ose jo: Nuk është paraqitur asnje ankesë me shkrim nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.